



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

RREGULLA PËR KUSHTET E PËRGJITHSHME TË FURNIZIMIT ME ENERGJI

Prishtinë, gusht 2011



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.10, dhe Nenin 25 të Ligjit Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë, në seancën e mbajtur më 29.08.2011, miratoi:

RREGULLËN PËR KUSHTET E PËRGJITHSHME TË FURNIZIMIT ME ENERGJI

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulle është përcaktimi i kushteve të përgjithshme të furnizimit me energji, si dhe detyrat dhe obligimet e ndërmarrjeve energjetike dhe konsumatorëve. Në këtë rregull përshkruhen parimet e përgjithshme të kyçjes (aplikimi për kyçje, oferta, marrëveshja për kyçje dhe furnizim) dhe shfrytëzimit të sistemit, leximit, matjes, faturimit dhe arkëtimit, si dhe shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Dispozitat e rregullës janë të aplikueshme për ndërmarrjet e energjisë që ofrojnë shërbime të energjisë dhe bëjnë furnizimin me energji (në tekstin në vazhdim “ndërmarrjet e energjisë”), dhe për konsumatorët fundorë që shfrytëzojnë këto shërbime dhe energjinë (në tekstin në vazhdim “konsumatorët”).
2. Kushtet e përgjithshme të furnizimit me gaz nuk përfshihen në këtë rregull.

Neni 3

Struktura

1. Kjo rregull përmban:
 - 1.1. parimet dhe elementet e Marrëveshjes për Kyçje;
 - 1.2. kyçjen në sistem;
 - 1.3. shfrytëzimin e sistemit;
 - 1.4. termat dhe kushtet e Kontratës për Furnizim;
 - 1.5. qasjen në pronë të Konsumatorit;



- 1.6. leximin e njehsorëve dhe faturimin;
 - 1.7. pagesën e faturave dhe shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë;
 - 1.8. kompensimin e konsumatorëve për mospërmbushjen e kushteve të përgjithshme të furnizimit.
2. Shtojcat e kësaj rregulle përmbajnë format e aplikacioneve për kyçje dhe furnizim, ofertat për kyçje dhe kontrata për furnizim dhe japin vetëm elementet bazë që duhet të përmbajnë dokumentet përkatëse; furnizuesi mund t'u shtojë këtyre formave çfarëdo informate tjetër të nevojshme, në rast se këto informata janë në pajtim me parimet e vendosura në këtë rregull dhe nuk bien ndesh me to në asnjë mënyrë.
 3. Format e standardizuara të përgatitura nga ndërmarrja e energjisë në përputhje me Nenin 3, paragrafi 2, do të dorëzohen për miratim në Zyrën e Rregullatorit për Energji ("ZRRE") dhe do të publikohen në faqen elektronike zyrtare të ndërmarrjes së energjisë.

Neni 4

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **"Marrëveshja për Aderim"** - dokumenti i nënshkruar nga të gjitha palët të cilat janë pajtuar që t'u përmbahen Rregullave të Tregut;
 - 1.2. **"Taksa e aplikimit"** - taksa që mbulon shpenzimet administrative të operatorit të sistemit për procedimin e aplikacionit për kyçje, të publikuar nga furnizuesi pas miratimit të ZRRE-së;
 - 1.3. **"Periudha e faturimit"** - periudha e specifikuar në ditë, duke filluar nga dita e nxjerrjes së llogarisë së fundit deri në ditën kur fatura do të dërgohet në adresën e Konsumatorit, ashtu siç është specifikuar në kontratën e furnizimit;
 - 1.4. **"Marrëveshja për kyçje"** - marrëveshja ndërmjet operatorëve të sistemit dhe shfrytëzuesve të sistemit, që përshkruan procedurën e kyçjes, fillimin e kyçjes, mirëmbajtjen, operimin dhe përfundimin e kyçjes në sistem;
 - 1.5. **"Kontrata për furnizim"** - marrëveshja ndërmjet furnizuesit dhe konsumatorëve fundorë;
 - 1.6. **"Metodologjia e taksave për kyçje"** - metodologjia e zhvilluar nga operatorët e sistemit, në përputhje me Nenin 7 të kësaj rregulle;
 - 1.7. **"Taksa e kyçjes"** - taksa që do të paguhet nga shfrytëzuesit e sistemit për kyçje në rrjet;
 - 1.8. **"Energjia"** - çdo formë e prodhuar ose e përfituar e energjisë (energji elektrike, energji dhe ngrohjes) me qëllim të furnizimit ose shitjes;
 - 1.9. **"Ndërmarrja e energjisë"** - një person ose entitet që ligjërisht ushtron një ose më shumë aktivitete të energjisë dhe është përgjegjëse për detyrat komerciale, teknike dhe/ose të mirëmbajtjes që kanë të bëjnë me ato aktivitete;
 - 1.10. **"Marrëveshja Kornizë e Rregullave të Tregut"** - marrëveshja ndërmjet operatorëve të sistemit dhe shfrytëzuesve të sistemit, sipas së cilës Rregullat e Tregut bëhen detyruese në mes palëve (më tutje **Marrëveshja Kornizë**);



- 1.11. **“Rrjeti”** - infrastruktura e nevojshme për transmetimin ose shpërndarjen e energjisë (energjisë elektrike ose ngrohjes);
 - 1.12. **“Pala Aplikuese”** - pala e cila aplikon që të jetë palë nënshkruese e Marrëveshjes për Aderim;
 - 1.13. **“Furnizuesi”** - ndërmarrja e licencuar e energjisë që furnizon konsumatorët me energji; me këtë përfshihen furnizuesi publik dhe furnizuesit e tjerë;
 - 1.14. **“Sistemi”** - një sistem që shërben për transmetim dhe shpërndarje të energjisë elektrike ose energjisë termike për klientët;
 - 1.15. **“Operatori i sistemit”** - operatori i licencuar i sistemit të transmissioinit apo shpërndarjes së energjisë elektrike dhe operatori i licencuar i sistemit të shpërndarjes së ngrohjes;
 - 1.16. **“Shfrytëuesi i sistemit”** - personi fizik ose juridik që jep ose merr energji në dhe nga sistemi i rrjetit të transmissioinit dhe/ose shpërndarjes;
 - 1.17. **“Shfrytëzim i paautorizuar i energjisë”** - nënkupton shfrytëzimin e energjisë ashtu siç është e përcaktuar në kreun e VIII të kësaj rregulle;
 - 1.18. **“Shfrytëzimi i pakontraktuar”** - shfrytëzimi i energjisë siç është përcaktuar në Nenin 29, paragrafi 1 të kësaj rregulle;
2. Termat e tjerë të përdorur në këtë rregull kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Ngrohjen Qendrore dhe ligjet e tjera në fuqi në Kosovë.

KREU II

PARIMET E PËRGJITHSHME, TË DREJTAT DHE OBLIGIMET

Neni 5

Furnizimi me energji elektrike

1. Në përputhje me dispozitat e kësaj rregulle, të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe obligimin që:
 - 1.1. të kenë trajtim të drejtë dhe jodiskriminues gjatë furnizimit me energji elektrike nga furnizuesit, si dhe të kenë qasje të hapur në informata nga furnizuesi;
 - 1.2. të kërkojnë kyçe të objekteve dhe pajisjeve të tyre energjetike në rrjetin e operatorit të sistemit, nëse një kyçe e tillë është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur, sipas dispozitave të Kodit të Rrjetit ose Shpërndarjes, ndonjë kodi ose rregulle tjetër në fuqi;
 - 1.3. të kenë marrëdhënie kontraktuese transparente me furnizuesin;
 - 1.4. të paraqesin ankesa sipas dispozitave të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, kundër çdo akti të paligjshëm ose anashkalimi nga ana e furnizuesit;
 - 1.5. paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja;



1.6. marrin kompensim nga furnizuesi, për energjinë e padërguar ose për furnizim me shërbim dhe energji të cilësisë së dobët, që nuk është në përputhje me kontratën për furnizim me energji dhe standardet e furnizimit dhe shërbimit që iu ofrohet konsumatorëve.

2. Furnizuesi duhet:

- 2.1. të nënshkruajë marrëveshjen kornizë ose marrëveshjen për aderim me Operatorin e Sistemit të Transmisionit;
- 2.2. të nënshkruajë marrëveshjen për kyçje me operatorët e sistemit në emër të konsumatorëve;
- 2.3. të zbatojë dispozitat e kësaj rregulle, kodet teknike dhe çdo rregull tjetër në fuqi;
- 2.4. të faturojë dhe të arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve;
- 2.5. të hartojë ofertat, kontratat, faturat, deklaratat dhe njoftimet që u adresohen konsumatorëve;
- 2.6. të themelojë një departament përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorëve, ofrimin e informacioneve, përkrahjen dhe këshillimin e tyre;
- 2.7. të mbajë dhe të azhurnojë (rifreskojë) të dhënat për matjen, faturimin dhe pagesën e faturave ose të dhënave të tjera të nevojshme, ashtu siç përcaktohet në këtë rregull dhe në kodet përkatëse;
- 2.8. të merret me ankesat e konsumatorëve sipas dispozitave të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- 2.9. t'u ofrojë konsumatorëve shërbime në përputhje me Standardet e Kualitetit të furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike dhe rregullat e tjera në fuqi;
- 2.10. t'u sigurojë konsumatorëve një përmbledhje me shkrim mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, në veçanti në kohën e nënshkrimit apo ndryshimit të Kontratës së Furnizimit. Përshkrimi i të drejtave dhe obligimeve të konsumatorëve duhet të miratohen nga ZRRE-ja;
- 2.11. që paraprakisht të paraqesë për rishikim dhe miratim në ZRRE, formën e Kontratës për Furnizim që iu është ofruar konsumatorëve;
- 2.12. të sigurojë informacione për konsumatorët në emër të operatorit të sistemit.

3. Operatori i Sistemit duhet:

- 3.1. të zbatojë dispozitat e kësaj rregulle, kodet teknike dhe rregullat e tjera në fuqi;
- 3.2. të përgjigjet brenda tridhjetë (30) ditësh ndaj çdo aplikimi për kyçje që është dorëzuar nga shfrytëzuesit e sistemit ose konsumatorët e kualifikuar;
- 3.3. të bëjë kyçjen e çdo aplikuesi për kyçje në sistem nëse kjo kyçje është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur sipas kushteve të vendosura në këtë rregull, kodeve teknike e marrëveshjeve përkatëse për kyçje dhe rregullave tjera në fuqi;
- 3.4. të mirëmbajë kyçjet dhe rrjetin në përputhje me dispozitat e kodeve teknike dhe marrëveshjeve përkatëse për kyçje;
- 3.5. të arkëtojë prej shfrytëzuesve të sistemit taksat për shfrytëzim të sistemit;
- 3.6. të sigurojë lexim të saktë dhe të rregullt të njehsorëve;



- 3.7. të mbajë dhe të azhurnojë të dhënat në lidhje me kyçjen, marrëveshjet për kyçje, aplikacionet për kyçje dhe për ndryshime të kyçjes; faturimin ndaj shfrytëzuesve të sistemit, ndërprerjet e paplanifikuara dhe të planifikuara në furnizim dhe përputhshmërinë me kriteret e cilësisë dhe të gjitha të dhënat e tjera në përputhje me dispozitat e rregullave të tjera në fuqi;
 - 3.8. të shqyrtojë ankesat me shkrim në lidhje me çështjet e njehsorëve;
 - 3.9. të testojë dhe të riparojë kyçjet dhe njehsorët;
 - 3.10. të sigurojë furnizuesit me informacione në lidhje me kyçjen dhe shfrytëzimin e sistemit;
 - 3.11. të shmangë çdo diskriminim gjatë ofrimit të shërbimeve;
 - 3.12. të zhvillojë dhe të dorëzojë për shqyrtim dhe miratim në ZRRE, Metodologjinë e Taksave për Kyçje, përfshirë format për aplikimin për kyçje dhe shfrytëzim të sistemit, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë rregull dhe rregulla të tjera të nxjerra nga ZRRE-ja;
 - 3.13. të publikojë në faqen elektronike zyrtare Metodologjinë e Taksave për Kyçje të miratuar nga ZRRE-ja, si dhe të publikojë një njoftim në lidhje me këtë në gazetatat ditore.
4. Çdo furnizues dhe operator i sistemit është i detyruar që, në pajtim me këtë rregull, të hartojë metodologji/procedura në lidhje me kushtet për kyçjen në sistem dhe furnizimin me energji brenda nëntëdhjetë (90) ditësh kalendarike pas marrjes së licencës. Të gjitha këto metodologji/procedura duhet të jenë transparente dhe jodiskriminuese dhe t'i paraqiten ZRRE-së për shqyrtim dhe miratim, si dhe të publikohen në faqen zyrtare elektronike.

Neni 6

Furnizimi me ngrohje

1. Të gjithë konsumatorët fundorë kanë të drejtë që, nëse është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur, të gëzojnë shërbimin e furnizimit me ngrohje prej rrjeteve të ndërmarrjeve të ngrohjes të cilat kryejnë shërbime publike, në përputhje me këtë rregull.
2. Sezoni i ngrohjes fillon prej datës 15 tetor dhe zgjat deri me 15 prill; në varësi të kushteve klimatike, sezoni i ngrohjes mund të shkurtohet ose të zgjatet (furnizim i jashtëzakonshëm me ngrohje).
3. Sezoni i ngrohjes mund të zgjatet maksimalisht nga data 1 tetor deri me 30 prill, duke aplikuar furnizimin e jashtëzakonshëm me ngrohje sipas kushteve në vijim:
 - 3.1. furnizimi i jashtëzakonshëm me ngrohje do të aplikohet në rast se, sipas të dhënave të shërbimeve meteorologjike ose sipas të dhënave prej ndërmarrjeve të ngrohjes, temperatura e jashtme e matur në orën 21:00, në zonën e mbuluar prej ndërmarrjes së ngrohjes qendrore, për tri ditë rresht regjistrohet më ulët se 12⁰C;
 - 3.2. furnizimi i jashtëzakonshëm me ngrohje do të përfundojë kur, sipas të dhënave të shërbimeve meteorologjike ose sipas të dhënave prej ndërmarrjeve të ngrohjes, temperatura e jashtme e matur në orën 21:00 në zonën e mbuluar prej ndërmarrjes së ngrohjes qendrore, për tri ditë rresht regjistrohet më e lartë se 12⁰C.
4. Ndërmarrja e ngrohjes do ta ndërpresë përkohësisht furnizimin me ngrohje gjatë sezonit të ngrohjes vetëm në rastet kur, sipas të dhënave të shërbimeve meteorologjike ose sipas të



dhënave prej ngrohtores, temperatura e jashtme e matur në orën 21:00 në zonën e mbuluar prej ndërmarrjes së ngrohjes qendrore, për dy ditë rresht regjistrohet 12⁰C, ose është më e lartë, dhe kur parashikimet e motit prej shërbimeve meteorologjike parashohin se temperatura për tri ditët në vijim do të jetë më e lartë se 12⁰C.

KREU III

KYÇJA NË SISTEM

Neni 7

Parimet e përgjithshme të Metodologjisë së taksave për kyçje

1. Operatorët e sistemit duhet të zhvillojnë Metodologjinë e taksave për kyçje në përputhje të plotë me Metodologjitë Tarifore të miratuara nga ZRRE-ja, që përfshijnë taksat për:
 - 1.1. aktivitetet paraprake të nevojshme për të dizajnuar, ndërtuar, komisionuar dhe mirëmbajtur kyçjen, si përgjigje ndaj një aplikimi nga shfrytëzuesit e sistemit;
 - 1.2. instalim të linjave elektrike ose gypave për ngrohje, pajisjeve matëse dhe pajisjeve të tjera energjetike për qëllim të kyçjes në pikat hyrëse ose dalëse në rrjetë;
 - 1.3. aktivitete për kyçje ose modifikim (ndryshim) të rrjetit;
 - 1.4. rrethanat kur linjat elektrike, gypat për ngrohje ose pajisjet energjetike për instalim janë të një madhësie më të madhe sesa është kërkuar për shfrytëzim të rrjetit;
 - 1.5. mirëmbajtje dhe riparim (përfshirë çdo shpenzim kapital) të kërkuar për kyçje, si dhe ofrim e instalim të njehsorëve për të bërë një kyçje në rrjet, nëse është e aplikueshme;
 - 1.6. shkyçjen nga rrjeti dhe heqjen e pajisjeve (stabilimenteve energjetike, linjave elektrike, pajisjeve matëse, gypave për ngrohje);
 - 1.7. deaktivizimin e kyçjes në rast kur një stabiliment i energjisë është i konservuar por i gatshëm për funksionim.
2. Metodologjia e Taksave për Kyçje duhet të përmbajë dispozita lidhur me të drejtën e aplikuesve për të bërë ankesë në ZRRE, kundër ofertave për kyçje të ofruara nga operatorët e sistemit.
3. Metodologjia e taksave për kyçje duhet të hartohet në atë mënyrë që të mos ketë diskriminim ndërmjet palëve të ngjashme që kyçen në rrjet kur bëhet vënia e taksave për kyçjet e reja ose për zëvendësimin ose ndryshimin e kyçjes ekzistuese.

Neni 8

Aplikimi për kyçje

1. Bazuar në Metodologjinë e Taksave për Kyçje, aplikuesi dorëzon aplikacionin te furnizuesi i cili e procedon tek operatori i sistemit, sipas Shtojcës A të kësaj rregulle.
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1, nëse aplikuesi është gjenerator, atëherë aplikacionin e dorëzon drejtpërdrejt te operatori i sistemit.



Neni 9

Oferta për kyçje

1. Pas regjistrimit të aplikacionit për kyçje/modifikim të kyçjes ekzistuese, Operatori i Sistemit duhet të bëjë marrëveshjet e nevojshme që të studiojë kërkesat teknike të kyçjes, nëse është e nevojshme, të vizitojë pronat që janë subjekt i aplikimit dhe ta hartojë dhe ta dërgojë ofertën për kyçje në formë të shkruar, sipas shtojcës B të kësaj rregulle.
2. Oferta për kyçje duhet të përmbajë të dhënat:
 - 2.1. për punët e nevojshme për të kyçur një shfrytëzues të sistemit në rrjetet ekzistuese të transmisionit ose shpërndarjes, si dhe marrjen e pëlqimit të nevojshëm për këtë qëllim; të emërtuar si “ kyçje e cekët”, për aplikuesit, siç është përcaktuar në Metodologjitë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje;
 - 2.2. për punët e nevojshme për të kyçur një shfrytëzues të sistemit në rrjetet ekzistuese të transmisionit ose shpërndarjes, si dhe marrjen e pëlqimit të nevojshëm për këtë qëllim në rastin kur kërkohet zgjerim ose përforcim në rrjetin e transmisionit ose shpërndarjes, për të rregulluar kërkesën e supozuar ose kriteret për kapacitet e aplikuesit; të emërtuar si “kyçje e thellë”, për aplikuesit, siç është përcaktuar në Metodologjitë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje;
 - 2.3. një taksë standarde të kyçjes të përcaktuar në pajtim me Metodologjitë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje për aplikuesit që furnizohen nga një nivel i caktuar tensioni dhe që bien brenda kufijve të ngarkesës dhe distancës maksimale të caktuar nga rrjeti ekzistues i shpërndarjes;
 - 2.4. për instalimin e njehsorëve të përshtatshëm të kërkuar që mundësojnë matjen e energjisë elektrike ose ngrohjes nga operatori i sistemit, në pikat hyrëse dhe dalëse;
 - 2.5. për instalimin e ndërprerësve ose pajisjeve të tjera sipas kërkesës;
 - 2.6. për instalimin e njehsorëve intervalë të telemetrisë ose pajisjeve për procesim të të dhënave me qëllim që t’iu mundësojë aplikuesve të cilët janë të detyruar që t’i kenë këto pajisje për të qenë në përputhje me Rregullat e Tregut.
3. Përveç kriteve të përcaktuara në Nenin 9, paragrafi 2, të kësaj rregulle, në rastet e kyçjes në rrjetin e shpërndarjes së ngrohjes, oferta për kyçje duhet të përmbajë gjithashtu kushtet teknike të kyçjes, të cilat i bashkëngjiten ofertës dhe të cilat duhet të përcaktojnë:
 - 3.1. parametrat teknikë të sistemit të ngrohjes qendrore;
 - 3.2. vendndodhjen e nënstacionit brenda ndërtesës së Konsumatorit, duke specifikuar pikën e kyçjes dhe mënyrën e kyçjes në tubacionin e furnizimit;
 - 3.3. kufijtë e pronësisë së instalimit brenda nënstacionit;
 - 3.4. rrjedhjen e projektuar të fluidit bartës të ngrohjes dhe tabelat e rregullimit;
 - 3.5. kriteret që kanë të bëjnë me nënstacionin për sa i përket kriteve specifike të ndërtimit për nënstacionet, specifikimin e pajisjeve të nënstacionit dhe vendndodhjet e valvuleve për kontrollin e rrjedhjes, njehsorin e ngrohjes dhe njehsorin për ujin e trajtuar që furnizon sistemin dytësor;
 - 3.6. kriteret në lidhje me instalimin e brendshëm të ngrohjes.



4. Në përpilim të një oferte për kyçje ose të një përgjigje ndaj një aplikacioni për kyçje, operatori i sistemit duhet të vendosë:
 - 4.1. datën në të cilën duhet kompletuar punët e kërkuara për lejim të qasjes në rrjet;
 - 4.2. taksat që duhet paguar në lidhje me shërbimet e kërkuara të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri me Metodologjinë e taksave për kyçje;
 - 4.3. kushtet e tjera të detajuara për çdo shërbim të kërkuar për qëllim të marrëveshjes.
5. Për qëllim të përcaktimit dhe vendosjes se taksës së përshtatshme të kostove në përqindje që janë shkaktuar direkt ose indirekt nga aplikuesi gjatë kryerjes së punëve sipas marrëveshjes për kyçje ose ndryshimin e një kyçjeje ekzistuese, Operatori i Sistemit duhet të marrë parasysh masën me të cilën:
 - 5.1. përfitimi nga kyçja do të jetë në dispozicion të të tjerëve, shfrytëzuesve të tanishëm dhe/ose të ardhshëm të sistemit, palëve të treta të cilat shërbehen nga operatori i sistemit;
 - 5.2. mund të mbledhë përqindjen e këtyre kostove prej shfrytëzuesve të sistemit të tanishëm dhe të ardhshëm ose prej palëve të treta, bazuar në përfitimin e përmendur në nënparagrafin 5.1;
 - 5.3. taksat e aplikimit për kyçje duhet të paguhen në tërësi para fillimit të punëve për kyçje.
6. Asnjë pagesë nuk do bëhet për përforcim të një rrjeti ekzistues nëse kërkesa për ngarkesë të re ose të shtuar nuk kalon 3% të kapacitetit efektiv ekzistues në pikën përkatëse në rrjet.
7. Oferta për kyçje duhet të lëshohet dhe të dërgohet te aplikuesi, e nëse aplikuesi është Konsumator përmes Furnizuesit, duke mos tejkaluar:
 - 7.1. tridhjetë (30) ditë kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit për kyçje në rrjetin me tension të ulët;
 - 7.2. nëntëdhjetë (90) ditë kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit për kyçje në rrjetin me tension të mesëm ose të lartë;
 - 7.3. tridhjetë (30) ditë kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit për kyçje në rrjetin e shpërndarjes së ngrohjes.
8. Në rast të vendosjes së kyçjes për një Konsumator të kualifikuar, oferta dhe marrëveshja për kyçje mund të nxirret dhe të dorëzohet pa përfshirë Furnizuesin. Konsumatori i kualifikuar në atë rast duhet të nënshkruajë Marrëveshjen për Aderim, e cila vendos detyrimet për pajtueshmëri me Rregullat e Tregut. Përpara nënshkrimit të Marrëveshjes për Aderim, Konsumatori i kualifikuar është i detyruar të marrë Licencën për Furnizim nga ZRRE-ja.
9. Afati i fundit për dorëzim të ofertës për kyçje mund të zgjatet në rast të ndonjë kyçjeje, komplekse që kërkon një studim paraprak teknik për zgjerim të rrjetit, ose për çfarëdo arsye tjetër që është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit ose Shpërndarjes apo kodeve të tjera në fuqi. Në këto raste studimi duhet të përfundohet brenda nëntëdhjetë (90) ditësh kalendarike prej ditës së dorëzimit të aplikacionit për kyçje, dhe oferta për kyçje duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike prej përfundimit të studimit përkatës.
10. Në rast se aplikuesi nuk është i kënaqur me kushtet e ofertës për kyçje, Metodologjia e Taksave për Kyçje lejon që aplikuesi të bëjë vetë studimin teknik me shpenzimet e veta, dhe që



operatori i sistemit do të bëjë të mundur lehtësimin e një studimi të tillë përmes dhënies së informacioneve të nevojshme, për të cilat mund të vendoset një taksë e përshtatshme.

Neni 10

Refuzimi për kyçje

1. Operatori i Sistemit mund të refuzojë të kyçë një aplikues përkohësisht ose përherë, vetëm nëse ajo kyçje nuk është e mundshme teknikisht ose ekonomikisht apo nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodet e tjera në fuqi.
2. Në rast të refuzimit të kyçjes, Operatori i Sistemit lëshon dhe dërgon tek aplikuesi një njoftim në formë të shkruar që paraqet arsyen e refuzimit brenda periudhës që nuk tejkalon tridhjetë (30) ditë kalendarike prej datës së dërgimit të aplikacionit, përkatësisht brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në Nenin 9, paragrafi 9, të kësaj rregulle.
3. Në këtë njoftim, Operatori i Sistemit duhet t'i referohet mundësisë së kyçjes në të ardhmen në përputhje me Planin zhvillimor të rrjetit, nëse është e aplikueshme.

Neni 11

Marrëveshja për kyçje

1. Brenda periudhës kohore të specifikuar në ofertën për kyçje, aplikuesi pranon ofertën duke i dërguar furnizuesit draft-marrëveshjen e nënshkruar për kyçje dhe paguan taksat përkatëse për kyçje në përfitim të operatorëve të sistemit.
2. Marrëveshja për kyçje përmbyllet në ditën e dërgimit të saj të nënshkruar te operatori i sistemit.
3. Marrëveshja për kyçje duhet:
 - 3.1. të përfshijë parimet themelore për taksat për kyçje të vendosura në Nenin 7 të kësaj rregulle;
 - 3.2. të përmbajë elementet lidhur me ofertën për kyçje, sipas Nenit 9 të kësaj rregulle;
 - 3.3. të përfshijë afatet në lidhje me fillimin, taksat, kushtet e pagesës, zgjidhjen e kontesteve dhe kushtet e ndërprerjes së marrëveshjes;
 - 3.4. të përfshijë standardet dhe kërkesat minimale të sigurisë, kërkesat në lidhje me vulosjen (pllombimin) e pajisjeve matëse dhe mbylljen me dry të vendit ku janë instaluar ndërprerësit, pajisjet matëse, transformatorët dhe qarqet matëse.

Neni 12

Kyçja

1. Me nënshkrimin e marrëveshjes për kyçje, operatori i sistemit duhet ta realizojë kyçjen siç është specifikuar në atë marrëveshje.
2. Me realizimin e kyçjes, operatori i sistemit duhet të lëshojë raport që konfirmon që kyçja është bërë në përputhje me afatet dhe kushtet e marrëveshjes për kyçje, dhe atë raport duhet ta



paraqesë të shfrytëzuesit e sistemit.

3. Kyçja e realizuar e shfrytëzuesve fundorë në pajtim me dispozitat e lartshënuara do të mbetet e vlefshme në rast të çdo ndryshimi të statusit të furnizuesit, nëse marrëveshja për kyçje nuk është ndërprerë.
4. Kyçja e Konsumatorit do të aktivizohet (lëshohet) vetëm me udhëzim të shkruar nga Furnizuesi dhe të dërguar te Operatori i Sistemit, me të cilën konfirmon se është nënshkruar Kontrata për Furnizim dhe janë plotësuar të gjitha kriteret për furnizim.
5. Mirëmbajtja e elementeve të kyçjes së thellë do të jetë përgjegjësi e operatorëve të sistemit të Transmisionit ose Shpërndarjes sipas kushteve të përshkruara në Metodologjinë e Taksave të Kyçjes. Operatori i Sistemit do të jetë i autorizuar të vendosë një taksë fillestare të përshtatshme për kostot e kapitalizuara të mirëmbajtjes së kyçjeve të cekëta që aplikohen në mënyrë jodiskriminuese ndaj të gjithë shfrytëzuesve të këtyre kyçjeve.
6. Neni 12, paragrafi 5, i kësaj rregulle nuk do të aplikohet ndaj kyçjeve ekzistuese që janë në pronësi të konsumatorëve. Për mirëmbajtjen e këtyre kyçjeve, operatorët e sistemit do të ngarkojnë konsumatorët në mënyrë të vazhdueshme sipas çmimoreve të miratuara nga ZRRE-ja, dhe me tarifa të cilat do të mund të rregullohen në mënyrë të përshtatshme. Mirëmbajtja e kyçjes përfshin mirëmbajtjen e kabllave/përçuesve të lidhura në rrjetin e operatorit, aparaturat matëse dhe siguresat hyrëse (nëse aplikohen) të kutive matëse. Kjo do të mund të kryhet vetëm nga operatorët e sistemit të Transmisionit ose Shpërndarjes.
7. Konsumatorët që kanë në pronësi të tyre pika kyçjeje, përfshirë aparaturat matëse, mund t'i transferojnë asetet e tyre te operatorët e sistemit pa asnjë kompensim, pas sjelljes së tyre në gjendje të rregullt siç kërkohet në kodet teknike të nxjerra nga operatorët e sistemit dhe miratuar nga ZRRE-ja. Prej datës kur do të bëhet transferimi i këtyre aseteve nga konsumatorët, do të aplikohen dispozitat e Nenit 12, paragrafi 5, të kësaj rregulle. Asetet e transferuara do të përfshihen në bazën e aseteve të operatorit të sistemit që shfrytëzohet për qëllimet e miratimit të tarifave të rregulluara nga ZRRE-ja, në përputhje me parimet e përcaktuara në Metodologjitë e Tarifave.
8. Në rast kur konsumatorët do të shfrytëzojnë dispozitën e Nenit 12, paragrafi 6, të kësaj rregulle, Operatori i Sistemit mund të kërkojë rregullimin e tarifës në përputhje me Rregullën mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike. Transferimi i mundshëm i aseteve që përcaktohet në Nenin 12, paragrafi 7, të kësaj rregulle, do të merret në shqyrtim në përputhje me Metodologjitë e Tarifave për Sektorin e Energjisë të miratuar nga ZRRE.



KREU IV

SHFRYTËZIMI I SISTEMIT

Neni 13

Parimet themelore të kostove të shfrytëzimit të sistemit

Taksat për shfrytëzim të sistemit janë të përcaktuara në Rregullën mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve) dhe Metodologjitë e Tarifave për Sektorin e Energjisë.

Neni 14

Aderimi në shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit

Me qëllim të shfrytëzimit të Sistemit të Transmisionit, Pala Aplikuese do të jetë nënshkruese e Marrëveshjes Kornizë ose do të nënshkruajë Marrëveshjen për Aderim me Operatorin e Tregut në rolin e vet si Palë e Autorizuar sipas Marrëveshjes Kornizë (tani e tutje “Pala e Autorizuar”).

Neni 15

Marrëveshja Kornizë

Palët e Autorizuara do të nënshkruajnë Marrëveshjen Kornizë me të cilën Rregullat e Tregut bëhen obliguese për palët në atë marrëveshje.

KREU V

KONTRATAT PËR FURNIZIM

Neni 16

Aplikimi për furnizim

1. Aplikacioni për furnizim duhet të dorëzohet nga aplikuesit te furnizuesi me qëllim që të lidhet kontrata për furnizim.
2. Konsumatorëve u kërkohet një aplikacion për furnizim në rast se ata ndryshojnë furnizuesin. Në rastet kur konsumatorët nuk kërkojnë zgjerim të kapacitetit të kyçjes, ata nuk kanë nevojë t’u përmbahen dispozitave të Neneve 8 dhe 9 të kësaj rregulle. Në rast se Konsumatori nuk është në përputhje me kriteret minimale komerciale, të sigurisë dhe mbrojtjes që janë përshkruar në Nenet 8, 9, 11 dhe 12 të kësaj rregulle, kyçja ekzistuese do të shkyçet në një datë të dakorduar që do t’i mundësojë Konsumatorit kyçje të re alternative në përputhje me kriteret e sipërpërmendura. Forma e aplikacionit për ndërrimin e furnizuesit është e paraqitur në Shtojcën A të kësaj rregulle.
3. Aplikacionet për furnizim duhet të bëhen në përputhje me formën standarde të përshkruar në Shtojcën A, së bashku me dokumentet e kërkuara. Furnizuesi është i obliguar që të regjistroj çdo aplikacion për furnizim.



4. Furnizuesi shqyrton aplikacionin brenda tri (3) javëve dhe nxjerr njoftim me shkrim në lidhje me qëndrimin e vet për ta pranuar ose për ta refuzuar aplikacionin. Ky afat kohor mund të zgjatet për (15) ditë kalendarike të tjera në rastet kur kërkohen informata shtesë. Aplikuesi duhet të informohet me shkrim rreth zgjatjes së afatit.
5. Furnizuesi duhet të zhvillojë dhe të paraqesë për miratim te ZRRE-ja procedurat në lidhje me kriteret për aplikuesit ose konsumatorët që të demonstrojnë aftësi pagese të kënaqshme për shërbime të reja ose vazhdim të shërbimeve, përfshirë çfarëdo kërkesë ose marrëveshje për pagesën e një depozite garancie sipas Nenit 24 të kësaj rregulle.
6. Aplikacioni për shërbim mund të refuzohet nëse aplikuesi nuk është në gjendje të paraqesë aftësi pagese të pranueshme sipas kësaj rregulle dhe politikave të miratuara nga Bordi i ZRRE-së.
7. Nëse një aplikuesi i refuzohet shërbimi, aplikuesi mund të fillojë kontestin në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Kontesteve në sektorin e energjisë. Nëse refuzimi vjen nga Operatori i Sistemit, Furnizuesi mund të iniciojë kontest në emër të Konsumatorit, në përputhje me Nenin 7, paragrafi 2, të kësaj rregulle.
8. Konsumatorët e kualifikuar mund të ndërrojnë furnizuesin, brenda tre (3) javëve pas njoftimit të furnizuesit të tyre aktual dhe nuk ka pagesë për ndërrimin e tillë; konsumatorët e mëdhenj josthtëpiakë do të kenë të drejtë të kontraktojnë njëkohësisht me disa furnizues, siç është përcaktuar në Nenin 19, paragrafi 2, të Ligjit për Energjinë Elektrike.
9. Ndryshimi i furnizuesit nga konsumatorët e kualifikuar do të bëhet në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregullat e Tregut të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

Neni 17

Kontrata për furnizim

1. Kontrata për furnizim duhet të jetë në përputhje me formën në Shtojcën C të kësaj rregulle, e cila i nënshtrohet modifikimeve ose plotësimeve që mund të propozohen nga Furnizuesi dhe të pranohen nga Konsumatori.
2. Kontrata për furnizim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Furnizuesi dhe Konsumatori dhe kyçja do të realizohet nga Operatori i Sistemit brenda një periudhe kohore e cila nuk i tejkalon pesë (5) ditë kalendarike. Pas kësaj bëhet njoftimi i pranimet të kyçjes dhe vërtetimi për përputhshmërinë me kriteret e kyçjes nga Operatori i Sistemit.
3. Furnizuesi do t'u komunikojë me shkrim Konsumatorit dhe Operatorit të Sistemit datën e fillimit të kontratës për furnizim. Përfaqësuesi i autorizuar i Operatorit të Sistemit do të bëjë kyçjen e re ose do të bëjë përmirësimin e kyçjes ekzistuese me anë të një udhëzimi me shkrim nga ana e furnizuesit. Pozitat e njehsorëve do të dakordohen nga përfaqësuesi i Furnizuesit, Operatori i Sistemit dhe Konsumatori në pajtim me standardet teknike dhe kodet relevante.
4. Për modifikimin e kontratave ekzistuese për furnizim do të aplikohet procedura e vendosur në Nenin 16, dhe bazuar në Nenin 9 të kësaj rregulle.



Neni 18

Marrëdhënia kontraktuese në rastet e furnizimit me ngrohje

1. Në ngrohjen qendrore, Konsumatori - pala kontraktuese konsiderohet pronari ose shfrytëzuesi i autorizuar i ndërtesës së pajisur me nënstacion dhe me rrjet dytësor të ngrohjes së brendshme.
2. Në rast të ndërtesave me shumë kate, të cilat përbëhen nga apartamente të shumta në pronësi individësh të cilët janë shfrytëzuesit fundorë të ngrohjes, Konsumatori – pala kontraktuese e furnizuesit do të konsiderohet një entitet ligjor që përmbush detyrat e veta të administrimit shtëpiak (p.sh. administrator, shoqata banesore, etj.) i cili do të krijohet në të ardhmen.
3. Deri në krijimin e administratës banesore në ndërtesat shumëkatëshe çdo pronar i apartamenteve do të konsiderohet si një Konsumator – palë kontraktuese e Furnizuesit.

Neni 19

Obligimi për furnizim

1. Furnizuesi publik është i detyruar që të furnizojë me energji çdo konsumator jo të kualifikuar që gjendet në zonën e mbuluar nga i licencuari për furnizim dhe që është i kyçur në rrjet në përputhje me marrëveshjen për kyçje dhe në bazë të dispozitave të kontratës për furnizim, dhe duke iu nënshtruar kriterëve të Neneve 8, 9, 11 dhe 12 të kësaj rregulle, përveç në rastet sipas Nenit 16, paragrafi 2, të kësaj rregulle.
2. I njëjti detyrim vlen për furnizimin e konsumatorëve të kualifikuar që, për çfarëdo arsyeje, nuk furnizohen më nga furnizuesit e përzgjedhur dhe duan të furnizohen nga furnizuesi publik me tarifa të rregulluara në përputhje me Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë. Për t'u furnizuar, Konsumatori i kualifikuar duhet t'iu nënshtrohet kriterëve të Neneve 8, 9, 11 dhe 12 të kësaj rregulle.

KREU VI

QASJA NË PRONË

Neni 20

Qasja në pronë të Konsumatorit

1. Konsumatori është i obliguar që t'iu lejojë qasje në pronën e tij përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 27, 28 dhe 29 të Ligjit për Energji.
2. Nëse Konsumatori nuk lejon qasje për leximin e pajisjeve matëse edhe pas marrjes së njoftimit me shkrim, energjia e furnizuar do të faturohet sipas shfrytëzimit në periudhat paraprake krahasuese siç përcaktohet në Nenin 19, paragrafi 5, të Rregullës mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.



3. Refuzimi i paarsyeshëm dhe i vazhdueshëm i Konsumatorit që t'i lejojë qasje në pronë ndërmarrjes së energjisë, mund të ndëshkohet sipas dispozitave të Rregullës për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

KREU VII

MATJA, FATURIMI DHE PAGESA

Neni 21

Leximi i njehsorëve

1. Operatori i Sistemit mund t'ia besojë leximin e njehsorëve furnizuesve ose ndonjë kontraktuesi tjetër. Në këtë rast, Operatori i Sistemit mbetet përgjegjës për të siguruar lexim të saktë dhe të rregullt dhe do të sigurojë që entiteti i kontraktuar për leximin e njehsorëve do të bëjë lexim të rregullt dhe të saktë të njehsorëve, në përputhje me Kodin përkatës të Matjes. Operatori i Sistemit duhet të krijojë dhe të paraqesë procedurën për lexim të njehsorëve të konsumatorëve në ZRRE për shqyrtim dhe miratim.
2. Në rast të kërkesës së konsumatorëve, Operatori i Sistemit është i obliguar që t'i sigurojë atij çfarëdo informate në lidhje me rezultatet e leximit të njehsorëve.

Neni 22

Testimi i njehsorëve

1. Në rast të kërkesës së Furnizuesit ose Konsumatorit dhe kurdo që është e nevojshme, Operatori i Sistemit është i obliguar t'i testojë njehsorët. Testimi dhe procedura e testimit të njehsorëve janë të përcaktuara në kodin përkatës të matjes
2. Operatori i Sistemit do të jetë i detyruar t'iu sigurojë furnizuesve çdo rezultat në lidhje me saktësinë e njehsorëve të testuar dhe, nëse është e aplikueshme, të bëjë rikthimin e humbjeve komerciale në përputhje me parimet përkatëse të kësaj rregulle, me Rregullën mbi Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, dhe Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike.

Neni 23

Faturimi i energjisë

1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme).
2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim.



3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.
4. Faturat duhet të dërgohen në adresën e Konsumatorit që është specifikuar në kontratën për furnizim. Nëse nuk është specifikuar adresa ose është specifikuar në mënyrë të pasaktë ose jo të plotë, ose nëse Konsumatori nuk gjendet më në adresën e specifikuar, Furnizuesi do ta bëjë dërgesën në vendndodhjen fizike ku ka ndodhur shfrytëzimi i energjisë. Nëse Konsumatori vazhdon me mospagesë, sipas Kontratës për Furnizim, me kërkesë të Furnizuesit, Operatori i Sistemit do ta shkyçë Konsumatorin nga rrjeti, në përputhje me Rregullën mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.
5. Kurdo që është e arsyeshme, furnizuesi mund ta kryejë dërgesën e faturës ose të njoftojë Konsumatorin duke dërguar me postë faturën në një lokacion që shihet apo në fqinjësinë e menjëhershme të lokacionit fizik ku ka ndodhur shfrytëzimi i energjisë.
6. Faturat mund të ndajnë pagesën për energjinë e shfrytëzuar prej të gjitha pagesave të tjera, duke përfshirë pagesat për shfrytëzim të rrjetit. Furnizuesi duhet të paraqesë një formë standarde dhe përmbajtje standarde të faturave te Bordi i ZRRE-së për rishikim dhe miratim para se të dërgohen te konsumatorët.

Neni 24

Depozitimi i garancisë

1. Nëse konsumatorët komercialë dhe shtëpiakë nuk janë të rregullt në pagesa, me rastin e rikycjes, furnizuesi ka të drejtë të kërkojë depozitim të garancisë.
2. Depozitimi i garancisë është një garanci adekuate që do të përlogaritet për të mbuluar faturat e ardhshme të vlerësuara për furnizim me energji për një periudhë prej dy (2) muajsh.
3. Depozitimet e garancisë duhet të paguhen me para në dorë ose përmes xhironlogarisë bankare.
4. Depozitimet e garancisë duhet t'i kthehen Konsumatorit pas ndërprerjes së Kontratës për Furnizim dhe pas rregullimit të borxhit të papaguar nëse ekziston, brenda periudhës njëmuajore nga data e ndërprerjes. Depozitimi i garancisë mund t'i kthehet Konsumatorit pas një viti, nëse dëshmohet në pagesat e rregullta të faturave të energjisë për periudhë të pandërprerë prej 12 muajsh.

Neni 25

Pagesa e faturave

1. Pagesa e faturave dhe depozitimet e garancisë duhet të bëhen me para në dorë në qendrën e specifikuar për arkëtim te Furnizuesi, çdo ditë të punës gjatë orëve të përshkruara, ose me ndonjë mjet tjetër të specifikuar në faturë apo në kontratën për furnizim.
2. Në rast të çfarëdo pagese që i bëhet Operatorit të Sistemit për shërbim, Konsumatorit duhet t'i lëshohet një dëftesë nga Furnizuesi. Furnizuesi do të mbajë një regjistër për të paktën pesë (5) vjet, në lidhje me pagesat dhe informacionet mbi pagesat.



3. Furnizuesi duhet të krijojë dhe të paraqesë procedurën për faturim të konsumatorëve në ZRRE për shqyrtim dhe miratim.
4. Procedura duhet të përmbajë periudhën prej datës së dorëzimit të faturës deri në datën e afatit të fundit të pagesës, si dhe periudhën pas afatit të lejuar para se të aplikohet kamata për mospagesë sipas Nenit 26 të kësaj rregulle.
5. Periudha prej dorëzimit të faturave të konsumatorët deri te afati i pagesës së borxhit për të gjitha pagesat aktuale nuk duhet të jetë më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë.
6. Periudha e lejuar pas afatit të fundit kohor para aplikimit të çfarëdo kamate ose interesi nuk do të jetë më pak se njëzet (20) ditë prej datës së kalimit të afatit të fundit për pagesë.
7. Mospranimi i faturës nuk e liron Konsumatorin nga obligimi për të paguar.
8. Dorëzimi i çdo ankese në lidhje me saktësinë e faturës nuk do të suspendojë obligimin e Konsumatorit për të paguar faturën, në të cilin rast Konsumatorit do t'i kërkohet që ta bëjë pagesën në përputhje me Nenin 19, paragrafi 5, të Rregullës për Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

Neni 26

Pasojat e mospagesave

1. Në rast të mospagesës, furnizuesi ka të drejtë të rregullojë borxhet e papaguara nga Konsumatori prej depozitimit garantues në çdo kohë. Në raste të tilla, furnizuesi mund të kërkojë nga Konsumatori që të bëjë një depozitë garantuese shtesë.
2. Në rast të mospagesës brenda periudhës së lejuar, siç përcaktohet në Nenin 25, paragrafi 6, të kësaj rregulle, Konsumatori mund të jetë i detyruar të paguajë kamatë për shumën e borxhit në normë të interesit të caktuar për muaj, pa paragjykim ndaj të drejtës së furnizuesit për të vënë gjoba për mospagim, sipas çdo klauzole të gjobave të përfshira në kontratën për furnizim. Normat e interesit do të miratohen nga ZRRE-ja për çdo vit fiskal, sipas kërkesës së furnizuesit.
3. Me vendim të Furnizuesit, këstet mujore për qëllim të shlyerjes së borxhit mund të dakordohen me Konsumatorin, pa paragjykuar detyrimin e Konsumatorit që të paguajë kamatat deri në shlyerjen e plotë të borxhit.
4. Furnizuesi mund t'ua transferojë të dhënat institucioneve të tjera, me qëllim të përmirësimit të normës së arkëtimit, ose me kërkesë t'ua dërgojë institucioneve të autorizuara në pajtim me ligjet e aplikueshme. Në rast të transferimit ose dërgimit të të dhënave të konsumatorëve furnizuesi duhet t'i përmbahet të drejtës së Konsumatorit për konfidencialitet, të parashikuar nga legjislacioni i aplikueshëm.

Neni 27

Shkyçja për mospagesë

Shkyçja për mospagesë mund të zbatohet vetëm si masë e fundit sipas dispozitave të Rregullës për Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.



Neni 28

Regjistrat në lidhje me Kontratat për Furnizim

1. Furnizuesit janë të detyruar që të mbajnë regjistrat e azhurnuara për:
 - 1.1. marrëveshjet e nënshkruara për kyçje për konsumatorët sa herë që kërkohet të kenë një marrëveshje përveç kontratës për furnizim;
 - 1.2. aplikacionet e paraqitura për furnizim;
 - 1.3. aplikacionet për modifikim (ngritje të kapacitetit ose ndryshim të grupit tarifor) të kontratave për furnizim;
 - 1.4. kontratat për furnizim të lidhura, të ndryshuara dhe të ndërprera;
 - 1.5. faturimin e konsumatorëve;
 - 1.6. të dhënat e tjera përkatëse në përputhje me dispozitat e rregullave të tjera të aplikueshme.

KREU VIII

SHFRYTËZIMI I PAAUTORIZUAR I ENERGJISË

Neni 29

Shfrytëzimi i pakontraktuar

1. Konsumatori do të konsiderohet se shfrytëzon energji në mënyrë të pakontraktuar nëse:
 - 1.1. shfrytëzon energji në një mënyrë ose në sasi që nuk është si ajo që i është miratuar nga ndërmarrja e energjisë;
 - 1.2. dështon të zbatojë specifikimet e nxjerra nga ndërmarrja e energjisë dhe nga kodet relevante të cilët aplikohen varësisht nga rasti, në lidhje me vendosjen, funksionimin dhe kyçjen e pajisjes së Konsumatorit, në instalimet elektrike ose të ngrohjes qendrore;
 - 1.3. transmeton energji pas pikës matëse, në një vend tjetër, pa lejen e ndërmarrjes së energjisë, dhe ia përçon një shfrytëzuesi tjetër në një vend të ndryshëm nga vendi i kyçjes në rrjetë, apo transmeton energji te një Konsumator që i takon një grupi tjetër tarifor;
 - 1.4. nuk nënshkruan kontratën me furnizuesin e energjisë brenda afatit të dhënë dhe vazhdon të shfrytëzojë energjinë pa kontratë.
2. Konsumatorët nuk duhet të ndryshojnë ose kryejnë ndonjë veprim në kyçje, pajisje matëse dhe aparate pa pëlqimin me shkrim nga ndërmarrja e energjisë dhe janë të obliguar që të raportojnë te furnizuesi sapo të kuptojnë për ndonjë prishje të shkaktuar në kyçje dhe në pajisjet matëse.
3. Ndërmarrja e energjisë është e obliguar që të përgjigjet në kërkesën e Konsumatorit në pajtim me rregullat në fuqi, dhe është e obliguar për të bërë kyçjen, pranimin, vendosjen, vulosjen e pajisjes matëse, si dhe, kur kërkohet nga Konsumatori apo shërbimi i caktuar, ndërrimin e pajisjes matëse.



Neni 30

Vjedhja e energjisë elektrike

1. Nëse Konsumatori kryen një nga shkeljet në lidhje me energjinë elektrike, preken (manipulimin), anashkalimin e matësve të energjisë elektrike, lidhjen ose rilidhjen me furnizim të energjisë elektrike që transmetohet nga ose përmes një sistemi të transmisionit ose shpërndarjes së energjisë elektrike pa autorizim, konsiderohen si vjedhje e energjisë elektrike, veprime këto që janë të specifikuara në Nenin 39 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

Neni 31

Vjedhja e ngrohjes

1. Nëse Konsumatori kryen një nga shkeljet në lidhje me ngrohjen qendrore, manipulimin, anashkalimin e matësve të energjisë termike, lidhjen ose rilidhjen me furnizim të ngrohjes qendrore nga sistemi i shpërndarjes pa autorizim, konsiderohen si vjedhje e ngrohjes qendrore, ashtu siç specifikohen më poshtë:
 - 1.1. kyçja (lidhja) direkte në rrjetin primar të ngrohjes ose në pjesën e rrjetit primar të nënstacionit termik;
 - 1.2. kyçja (lidhja) në sistemin sekondar të ngrohjes gjegjësisht në gypat e rrjetit sekondar në ndërtesë;
 - 1.3. largimi dhe/ose dëmtimi i blombave ose vulave të ndërmarrjes së ngrohjes qendrore;
 - 1.4. dëmtimi apo ndryshimi i dizajnit, funksionit dhe performancës së instalimeve dhe/ose njehsorit të energjisë termike me qëllim të shfrytëzimit të pa-autorizuar; dhe
 - 1.5. zgjerimi i hapësirës ngrohëse dhe instalimi i trupave ngrohës shtesë pa autorizim nga ndërmarrja e ngrohjes qendrore;

Neni 32

Llogaritja e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë

1. Nëse fillimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë nuk mund të përcaktohet, atëherë për konsumatorët shtëpiakë do të merret që shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë ka filluar gjashtë (6) muaj para datës kur Konsumatori është gjetur duke bërë shfrytëzim të paautorizuar të energjisë, ndërkaq për konsumatorët e tjerë dymbëdhjetë (12) muaj para datës kur Konsumatori është gjetur duke bërë shfrytëzim të paautorizuar të energjisë, ose nga dita e inspektimit të fundit kur instalimi ka qenë në rregull.
2. Për llogaritjen e faturave për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë do të zbatohen tarifat e aplikueshme në datën kur është zbuluar shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë, gjegjësisht në datën e përpilimit të procesit nga ekipi i kontrollit dhe për konsumatorët shtëpiakë do të zbatohen tarifat e grupit njëtarifor të ndara sipas sezoneve (verë, dimër), kurse për konsumatorët e tjerë do të zbatohet tarifa e lartë e grupit që i përket, gjithashtu e ndarë sipas sezoneve.
3. Ndërmarrja e energjisë (Furnizuesi/OSSH-ja) duhet të paraqesë për miratim në ZRRE procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë. Në këtë procedurë duhet të specifikohen:



- 3.1. llojet e abuzimeve në njehsor dhe ndërhyrjeve në kyçje sipas Nenit 30 të kësaj rregulle dhe veprimet që duhet të ndërmarrë ndërmarrja e energjisë për secilin lloj abuzimi të njehsorit dhe ndërhyrjeve në kyçje;
 - 3.2. veprimet që duhet të ndërmarrë ndërmarrja e energjisë në rast të shfrytëzimit të pakontraktuar të energjisë sipas Nenit 29, paragrafi 1, të kësaj rregulle; dhe
 - 3.3. në llogaritjen e energjisë së shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar, sipas Nenit 30 të kësaj rregulle, furnizuesi duhet të zbresë nga fatura e rikthimit të humbjeve energjinë e faturuar gjatë asaj periudhe (nëse ka faturuar).
4. Pa paragjykuar në kompetencat e ZRRE-së për të vënë gjoba sipas Nenit 52 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe ndaj çdo detyrimi penal ose civil, çdo dëm i shkaktuar nga aktivitetet e lartpërmendura mund të gjohet sipas dispozitave të Rregullës për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

Neni 33

Kompensimi i Konsumatorëve

Në rast se Furnizuesi dështon në zbatimin e procedurave për shkyçje sipas Rregullës për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, konsumatorët e prekur negativisht kanë të drejtë në kompensim prej furnizuesit për dëmet direkte dhe të pranuar si rezultat nga kjo. Furnizuesi duhet të paraqesë për rishikim dhe miratim në ZRRE procedurat për kompensime të tilla.

Neni 34

Gjobat

1. Në rastet kur Furnizuesi nuk i përmbush obligimet e tij për nënshkrim të marrëveshjes për kyçje me Operatorin e Sistemit në vend të Konsumatorit, ose nuk e furnizon Konsumatorin në përputhje me kontratën për furnizim, ZRRE ka autoritetin të vë gjoba për furnizuesin e tillë në përputhje me Nenin 52 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat dhe Gjobat Administrative.
2. Derrogimi i dispozitave të caktuara në kontratën për furnizim mund të lejohet në rastet kur Furnizuesi paraqet te ZRRE-ja arsyen që mund të provojë paaftësinë e përmbushjes të këtyre kërkesave dhe të propozojë masat dhe veprimet që mund të largojnë këto pengesa.

KREU IX

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 35

Gjuha zyrtare

Kjo rregull është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.



Neni 36
Ndryshimi

1. ZRRE mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të kësaj rregulle.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj rregulle do të jenë të njëjta si për miratim të saj.

Neni 37
Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 38
Shfuqizimi

Kjo rregull shfuqizon Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, të nxjerrë në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9 dhe të miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji më 27 maj 2009.

Neni 39
Hyrja në fuqi

Kjo rregulla hyn në fuqi nga dita e miratimit të saj nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar



SHTOJCA A APLIKACIONI PËR KYÇJE DHE FURNIZIM

1. Konsumatorët shtëpiakë

Kyçje e Re/Modifikim i një marrëveshjeje ekzistuese për kyçje
(Ju lutem fshijeni qëllimin që nuk është i aplikueshëm)

Për (furnizuesin) Numri Regjistruar: _____

Kërkoj nga ju të kyçni objektin e përshkruar më poshtë në rrjetin elektrikë/ngrohjes. (Ju lutem fshijeni rastin që nuk është i aplikueshëm)

1. Aplikuesi:

- a) Emri dhe mbiemri: _____
- b) Nr. i letërnjoftimit: _____
- c) Përfaqësuesi ligjor (nëse është e aplikueshme): _____
- d) Adresa: _____
- e) Nr. i telefonit: _____
- f) E-mail: _____
- g) Pronari/ shfrytëzuesi i autorizuar i objektit: _____

(nëse është i ndryshëm nga a))

2. Përfaqësues i aplikuesit:

- a) Emri dhe mbiemri: _____
- b) Përfaqësuesi ligjor (nëse është e aplikueshme): _____
- c) Adresa: _____
- d) Nr. i telefonit: _____
- e) E-mail: _____

3. Të dhënat për objektin për të cilin kërkohet kyçja:

- a) Rruga: _____
- b) Nr: _____
- c) Qyteti/Fshati: _____
- d) Kodi postar: _____
- e) Pronari: _____
- f) Shfrytëzuesi i autorizuar i objektit (nëse është e aplikueshme): _____

- g) Zona e ndërtuar e objektit/ngastra: _____



4. Shënimet teknike:

Shfrytëzimi i tokës nga objektet që do të kyçen: Bujqësore, Familjare dhe Komerciale

- a) Kapaciteti ekzistues i miratuar i lokacioneve (nëse është e mundshme). Kapaciteti i ri kërkohet me këtë aplikacion. Kapaciteti i instaluar _____ kW
- b) Sipërfaqja e pronës _____ m²
- c) Përshkrimi i pronës:
 - Bodrumi _____ m²
 - Dhoma e ditës _____ m²
 - Kuzhina _____ m²
 - Dhoma e fjetjes _____ m²
 - Të tjera _____ m² (për kalkulim të tarifës paushall nëse kërkohet)
 - Lokacioni i nënstacionit _____ m² (për ngrohje qendrore)
- d) Shënimet për kapacitetin dhe sasinë e energjisë që e shfrytëzojnë pajisjet e energjisë që do të kyçen: _____
- e) Lloji dhe parametrat e sistemit sekondar të Konsumatorit/instalimet e brendshme të ngrohjes (për ngrohje qendrore).

5. Kategoria tarifore e zgjedhur _____

6. Borxhet e vonuara:

- a) Çdo borxh i vonuar për energji elektrike/ngrohje në zonën e veprimit të të licencuarit në emër të aplikuesit:
Po/ Jo (Nëse përgjigja është 'Po', ju lutem jepni detajet)

- b) Çdo borxh i vonuar për energji elektrike/ngrohje për objektin për të cilin është aplikuar kyçja:
Po/Jo (Nëse përgjigja është 'Po', ju lutem jepni detajet)

7. Me këtë deklaroj se informatat në këtë aplikacion janë të vërteta me sa jam në dijeni.

8. Dokumentet e bashkangjitura të paraqitura:

- a) Dëshmi e dokumentuar e pronësisë/autorizim për shfrytëzim të pronës.(si p.sh. Leja për ndërtim, kontratat për shfrytëzim etj.) ;
- b) Dokument që dëshmon përfaqësuesin ligjor;
- c) Dëshmi e dokumentuar për autorizim për të dorëzuar aplikacionin e tashëm;
- d) Skica e hartës së objektit, që jep dëshmi për pikën e furnizimit;
- e) Skica e planit të nënstacionit dhe instalimeve të brendshme të ngrohjes (për ngrohje qendrore);
- f) Dëftesa zyrtare e pagesës së taksës në aplikim.



9. Aplikuesi/Aplikuesi i autorizuar:

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Vendi: _____

10. Nënshkrimi dhe pronësia e lokacionit ku është sugjeruar në pikën 1, g) që aplikuesi është pronar i ri:

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Vendi: _____

2. Konsumatori komercial

Kyçja e re/Modifikimi i një marrëveshjeje ekzistuese për kyçje dhe furnizim
(Ju lutem fshijeni qëllimin që nuk është i aplikueshëm)

Për furnizuesin Numri Regjistruar: _____

Kërkoj nga ju të kyçni objektin e përshkruar më poshtë në rrjetin e energjisë elektrike/ngrohjes. (Ju lutem fshijeni rastin që nuk është i aplikueshëm)

1. Aplikuesi:

a) Emri dhe mbiemri: _____

b) Përfaqësuesi ligjor (nëse është e aplikueshme): _____

c) Numri i regjistrimit të biznesit: _____

d) Lloji i biznesit: _____

e) Adresa: _____

f) Nr. i telefonit: _____

g) E-mail: _____

h) Pronari/ shfrytëzuesi i autorizuar i objektit: _____

(nëse është i ndryshëm nga a))

2. Përfaqësuesi i aplikuesit:

a) Emri dhe mbiemri: _____

b) Përfaqësues ligjor (nëse është e aplikueshme): _____

c) Adresa: _____

d) Nr. telefonit: _____

e) E-mail: _____



3. Të dhënat për objektin për të cilin kërkohet kyçja:

- a) Rruga: _____
- b) Nr: _____
- c) Qyteti/Fshati: _____
- d) Kodi postar: _____
- e) Pronari: _____
- f) Shfrytëzuesi i autorizuar i objektit: _____
- g) Zona e objektit të ndërtuar/ngastra: _____

4. Shënimet teknike:

- a) Kapaciteti i kërkuar _____ kW (kW_t - ngrohje qendrore)
- b) Përshkrimi i shfrytëzimit të pronës dhe sipërfaqes së hapësirës që do të furnizohet nga kjo kyçje _____
- c) Lloji dhe parametrat e sistemit sekondar të Konsumatorit / instalimet e brendshme të ngrohjes (për ngrohje qendrore).
- d) Shënimet për kapacitetet dhe sasinë e energjisë që e shfrytëzojnë pajisjet e energjisë që do të kyçen: _____
- e) Sipërfaqja e pronës: _____ m²

5. Kategoria tarifore e zgjedhur: _____

6. Borxhet e vonuara:

- a) Çdo borxh i vonuar për energjinë elektrike / ngrohjes në zonën e veprimit të licencuarit në emër të aplikuesit:

Po/Jo (Nëse përgjigja është 'Po', ju lutem jepni detajet)

- b) Çdo borxh i vonuar për energji elektrike/ngrohje për objektin për të cilin aplikohet për kyçje:

Po/Jo (Nëse përgjigja është 'Po', ju lutem jepni detajet)

7. Ju lutemi përfshini në ofertën për Kyçje formën dhe llojin e pajisjeve matëse:

8. Me këtë deklaroj se informatat në këtë aplikacion janë të vërteta me sa jam në dijeni.

9. Me këtë kërkoj/nuk kërkoj konkludim të marrëveshjes plotësuese që siguron kushte specifike në lidhje me mirëmbajtjen e kyçjes, si vijon:

(Data me të cilën kyçja/zgjerimi i kapacitetit të kyçjes kërkohet. Koha maksimale e lejuar sipas Rregullës KPFE, Neni 5, paragrafi 3, dhe Neni 9, paragrafi 7, për t'u arritur një marrëveshje, përfshirë datën e kyçjes është nëntëdhjetë (90) ditë kalendarike)



10. Dokumentet e bashkangjitura:

- a) Dëshmi e dokumentuar e pronësisë / autorizim për shfrytëzim të pronës
- b) Dëshmi e dokumentuar për Nenin e Asociacionit/ Vendimit të Gjykatës/ Kopjes së Librit të Aksionarëve
- c) Dëshmi e dokumentuar e përfaqësuesit ligjor
- d) Dëshmi e dokumentuar për autorizim për dorëzim të aplikacionit të tanishëm
- e) Skica e hartës së objektit, që jep indikacion për pikën e furnizimit
- f) Dëftesa zyrtare e pagesës së taksës në aplikim
- g) Skica e planit të nënstacionit dhe instalimeve të brendshme të ngrohjes (për ngrohje qendrore)

11. Aplikuesit/Aplikuesi i autorizuar:

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Vendi: _____



SHTOJCA B
OFERTA PËR KYÇJE (PARAQITUR TE FURNIZUESI)

Operatori i Sistemit: _____

Numri i regjistrimit të aplikacionit: _____

Emri dhe mbiemri i Konsumatorit: _____

Adresa e Konsumatorit: _____

Furnizuesi: _____

1. Oferta e tanishme për kyçje është pjesë integrale e marrëveshjes së propozuar për kyçje.

2. Zgjidhja e propozuar teknike:

a) Pika e kyçjes: _____

b) Përshkrimi i rregullimeve dhe pajisjeve të domosdoshme teknike që duhet të përdoren për kyçje:

c) Data e planifikuar e kyçjes: _____

d) Niveli i tensionit, kapaciteti maksimal dhe energjia:

3. Kostot e kyçjes: _____

4. Përshkrimi i pajisjeve për matje dhe mbrojtje që duhet të instalohen:

5. Çështjet e ndërlidhura me shfrytëzim të rrjetit:

a) Tarifa e rekomanduar: _____

b) Metoda dhe afatet për pagesë të kostove dhe taksave për shfrytëzimin e rrjetit (kreditë e dhëna për kostot që mbulohen nga Konsumatori) :

6. Afati për pranimit të ofertës për kyçje dhe propozimi për zgjidhje alternative teknike:

(Afatet e tilla nuk mund të jenë më të shkurtra se pesëmbëdhjetë (15) ditë pune pas dorëzimit të ofertës për kyçje)



SHTOJCA C KONTRATA PËR FURNIZIM

Furnizuesi: _____

Emri dhe adresa e Konsumatorit: _____

Pika e furnizimit dhe pika e kufirit: _____

Niveli i tensionit dhe kapaciteti i garantuar: _____

Përkatësia Grupit të konsumatorëve: _____

Data e fillimit të furnizimit me energji: _____

(Jo më vonë se gjashtë ditë pasi të jetë lidhur kontrata e furnizimit)

Lloji i tarifës: _____

Periudha e faturimit: _____

Sistemi i kalkulimit dhe lëshimit të faturave *(vlerat e parakalkuluara, telemetrike, leximit në vend të njehsorëve të energjisë)*

Depozita e Garancisë *që mbulon shumën e përafërt të pagesës për furnizim të energjisë për periudhën dy (2) mujore (nëse është e aplikueshme):*

Neni 1

Të drejtat dhe obligimet e konsumatorëve

1. Pa paragjykuar ndonjë dispozitë të ndonjë rregulle të aplikueshme, konsumatorët kanë të drejtat dhe obligimet në vazhdim:
 - 1.1. të marrin energji ashtu siç është specifikuar në kontratën për furnizim dhe marrëveshjen për kyçje (nëse është e aplikueshme);
 - 1.2. të shfrytëzojnë energjinë e tillë në përputhje me kontratën e furnizimit dhe të mënjanojnë shkaktimin e ndonjë shtrembërim në rrjedhjen e energjisë;
 - 1.3. të paguajnë faturat për energjinë e shfrytëzuar ashtu siç është matur nga pajisjet matëse si dhe shfrytëzimin e rrjetit, në përputhje me tarifën e aplikueshme;
 - 1.4. sa më shpejtë të informojnë furnizuesin në rast të ndonjë ndërrimi të detajeve përkatëse, përfshirë adresat, personin e autorizuar etj.
 - 1.5. të mos shkelë ndonjë prej dispozitave të Nenit 5 të Rregullës për Shkyçje dhe Rikyçje në Sektorin e Energjisë në Kosovë (Shfrytëzim i Paligjshëm).

Neni 2

Të drejtat dhe obligimet e furnizuesit

1. Furnizuesi ka të drejtat dhe obligimet si në vijim:
 - 1.1. ta furnizojë Konsumatorin me energji në sasinë, datën, kohën dhe vazhdimësinë e dakorduar, në përputhje me dispozitat e kontratës për furnizim ose të ndonjë rregulle



ose rregulloreje tjetër të aplikueshme;

- 1.2. të sigurojë faturim korrekt të energjisë së shfrytëzuar;
- 1.3. të paguhet për energjinë e faturuar;
- 1.4. ta njoftojë Konsumatorin për arsyet e ndërprerjes në furnizim me energji;
- 1.5. të restaurojë rrjedhjen e energjisë pas ndërprerjes së arsyeve që kanë shkaktuar ndërprerje në furnizim;
- 1.6. të arrijë kualitetin e kërkesës së furnizimit me energji;
- 1.7. të mbledhë dhe të vëzhgojë të dhënat përkatëse për shfrytëzimin e energjisë nga konsumatorët.
- 1.8. të kompensohet për çfarëdo dëmtimi, humbjeje, të vërtetuara ose harxhimeve të shkaktuara si rezultat i shkeljes së Nenit 5 të Rregullës për Shkycje dhe Rikycje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë (Shfrytëzim i pakontraktuar. Vlera e një kompensimi të tillë duhet të vendoset në përputhje me orarin e dëmtimeve të vlerësuara që duhet të vendosen nga furnizuesi dhe miratohen nga ZRRE-ja.

Neni 3

Ruajtja e të dhënave

1. Konsumatorit i bëhet me dije që furnizuesi mund të mbajë detajet personale të tij për qëllim të administrimit të llogarisë së Konsumatorit dhe sigurim të shërbimit nga furnizuesi sipas kësaj kontrate dhe kryerjes së punëve të tjera të kërkuara nga ligji dhe për furnizuesin të praktikojë të drejtën e tij ligjore.
2. Ruajtja mund të vazhdojë pas mbylljes së llogarisë së Konsumatorit. Në veçanti, Konsumatorit i bëhet me dije që Neni 26 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji lejon furnizuesin t'i dërgojë informata institucioneve të autorizuar.

Neni 4

Depozita e garantimit (nëse është e aplikueshme)

1. Depozitimi i garantimit do të paguhet me para në dorë ose me depozitim në bankë.
2. Nuk do të ketë kamatë për depozitim e garantimit gjatë zbatimit të kontratës së furnizimit.
3. Depozitimi i garantimit do t'i kthehet Konsumatorit vetëm pasi të ndërpritet kontrata për furnizim dhe pasi të jenë rregulluar borxhet e mbetura, nëse ka ndonjë, brenda periudhës njëmuajore që nga data e ndërprerjes.
4. Në rast se nuk kthehet depozitimi i garantimit brenda periudhës së lartpërmendur, duhet t'i bartet vlera e kamatës me normë të interesit 8% për vite e paguar nga Konsumatori.



Neni 5

Obligimi i vazhdimësisë

Furnizuesi është përgjegjës për të siguruar furnizim të vazhdueshëm me energji përmes pikës së kyçjes pa prejudikuar ndonjë kusht të kontratës për kufizime kohore.

Neni 6

Ndërprerjet në furnizim

1. Në rast të ndonjë ndërprerjeje në furnizim, furnizuesi është i obliguar ta kthejë furnizimin me energji sa më shpejtë që është e mundur dhe të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për këtë arsye.
2. Me kërkesë të Konsumatorit, Furnizuesi do t'i ofrojë çdo informatë që ka në dispozicion në lidhje me kohëzgjatjen e ndërprerjeve të paplanifikuara dhe kohëzgjatjen e parashikuar që është e nevojshme për rikthimin e furnizimit me energji. Obligimi për të informuar konsumatorët nuk është i nevojshëm, nëse një informim i tillë nuk ka arsyetim praktik për të ofruar informata përkatëse dhe Furnizuesi nuk është përgjegjës për këtë.

Neni 7

Ndërprerjet e paplanifikuara

1. Në rast të ndërprerjeve të paplanifikuara të furnizimit me energji, konsumatorët duhet të njoftojnë furnizuesin me përpikëri.
2. Furnizuesi duhet të ofrojë shërbime emergjente me palët kontraktuese brenda periudhës e cila fillon nga njoftimi i ndërprerjes së paplanifikuar siç është vendosur në Standardet e Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike.

Neni 8

Ndërprerjet e planifikuara

Furnizuesi do t'i informojë konsumatorët për ndonjë ndërprerje në kohëzgjatjen e vlerësuar duke tejkaluar periudhën minimale të përcaktuar për riparimin e planifikuar në kontratën për furnizim, së paku njëzetekatër (24) orë më herët, pas pranimit nga Operatori i Sistemit, përveç nëse është ndonjë rast emergjent. Informatat duhet të ofrohen me çfarëdo mjeti të informimit që konsiderohet i qëlluar me synim që të sigurohet publicitet maksimal.

Neni 9

Kufizimet e furnizimit me energji për shkak të rrjetit

Në rast të kufizimit të furnizimit për shkak të kushteve të rrjetit, Furnizuesi ka të drejtë që t'iu ofrojë konsumatorëve sasi të kufizuar të energjisë. Në raste të tilla furnizuesi do të përpiqet që sa më shpejtë të informojë konsumatorët, së paku njëzetekatër (24) orë më herët.



Neni 10

Kërkesat për kualitet të furnizimit me energji

Furnizuesi do të furnizojë me energji elektrike në përputhje me kërkesat e kualitetit të paraqitura në kodet teknike dhe Standardet e Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike.

Neni 11

Faturimi dhe pagesa

Faturimi dhe pagesa duhet të jenë në përputhje me Nenet 23 dhe 25 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Neni 12

Gjobat

Gjobat janë të përcaktuara në Nenet 26, 27 dhe 34, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Neni 13

Zgjidhja e ankesave

1. Konsumatori duhet të raportojë menjëherë te Furnizuesi çdo ankesë në lidhje me shërbimet e ofruara ose çështjet e faturimit.
2. Ankesat i nënshtrohen Rregullës për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Neni 14

Ndërprerja e kontratës së furnizimit

1. Konsumatori mund të ndërpresë kontratën për furnizim pa arsyetuar pasi që të ketë përmbushur të gjitha obligimet e tij që rrjedhin nga kontrata dhe të ketë njoftuar me shkrim Furnizuesin për këtë rezultat së paku tri (3) javë më herët.
2. Furnizuesit që kryejnë shërbime mund të ndërpresin kontratën për furnizim vetëm duke pasur arsye dhe në përputhje me procedurat e ofruara në Rregullën për Shkycje dhe Rikycje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.
3. Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës për ngjarjet jashtë kontrollit të arsyeshëm, duke përfshirë por jo edhe kufizuar në katastrofat natyrore, vërshimet, zjarrin, tërmetin ose rastet e ngjashme si të grevave, sulmeve, protestave, konflikteve apo ngjarjeve të tjera të ngjashme.